

**AKT THEMELIMI**  
**"Laundry Room Magnolia" SH.P.K.**  
**(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Sot, më datë 05.11.2020, te nënshkruarat:

- **Znj.Irida Kuqi**, shtetase shqiptare, lindur ne Kruje dhe banuese ne Tirane, e datelindjes 20.12.1976, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal H66220132N, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

**DHE**

- **Znj. Laerta Hoxha**, shtetase shqiptare, lindur ne Tepelene dhe banuese ne Tirane, e datelindjes 17.08.1980, mbajtese e pasaportes me nr.personal I05817173W, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, sidheligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, kanevendosur të themelojmenjë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë referuar si "*Shoqëria*"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse dhe i bashkangjitet këtij Akti Themelimi.


**Neni 1**

Emri i shoqerise eshte "Laundry Room Magnolia", ndjekur pandashmerisht nga prapashtesa Sh.P.K, e cila perfaqeson formen ligjore te Shoqerise (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar). Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj me kete emertim.

**Neni 2**



1





Adresa kryesore e ushtrimit te aktivitetit te Shoqërisë ndodhet ne : Rruga e "Barrikadave", ish Kinama 17 Nentori, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, per zhvillimin e aktivitetit te saj.

### **Neni 3**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë per nje afat te pacaktuar ne kohe, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

### **Neni 4**

**Objekti i veprimtarise se Shoqërisë është si meposhte vijon:**

**Shoqeria ka per objekt veprimtarie te saj por pa u kufizuar vetem ne:**

"Pastrim kimik, lavanderi. Larje, tharje, hekurosje, paketim, ngjyrosje, lyerje dhe konfeksionime te ndryshme per çdo lloj tekstili. Dhenie me qira apo ne perdorim te materialeve per restorante, hotele, etj. Çdo lloj sherbimi tjetër qe ka lidhje me aktivitetin kryesor."

Te gjitha aktivitetet duhet te zhvillohen brenda limiteve dhe duke respektuar rregullat qe disiplinojne ushtrimin e kesaj veprimtarie.

### **Neni 5**

Kapitali baze i themelimit te Shoqerise "Laundry Room Magnolia" Sh.p.k eshte 10.000 (dhjetemije) leke, i cili eshte kontribut i dy ortakeve te saj ne masen, si me poshte:





**Znj. Irida Kuqi** zoteron 1 (nje) kuote me vlere 5.000 (pesemije) leke, qe perben 50% te kapitalit te shoqerise.

**Znj. Laerta Hoxha** zoteron 1 (nje) kuote me vlere 5.000 (pesemije) leke, qe perben 50% te kapitalit te shoqerise.

### **Neni 6**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejatat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratori

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve si dhe te Administratorit te Shoqerise jane te parashikuara ne statutin e Shoqerise.

### **Neni 7**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratori i Shoqerise.

### **Neni 8**

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj Shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

 3



## **Neni 9**

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'registrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

## **Neni 10**

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **Neni 11**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

## **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Persa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit" i ndryshuar.





**ORTAKET E SHOQERISE**  
**“Laundry Room Magnolia” Sh.p.k.**

Irida Kuqi  
Znj. Irida Kuqi

Irida Kuqi  
Irida Kuqi

Laerta Hoxha  
Znj. Laerta Hoxha

Laerta Hoxha